



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
ODA E FARMACISTËVE TË KOSOVËS
Komora Farmaceuta Kosova
Kosova Chamber of Pharmacists



Në mbështetje të nenit 21, paragrafi 1 dhe 4, nenit 40 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor nr.04/L-150, nenit 12, paragrafi 1 dhe 2, nenit 27 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të OFK-së, Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur me 12/10/2020, nxjerr këtë :

V E N D I M

- I. Afati i rregullt i pagesave të taksës administrative për anëtarësim për vitet 2018 dhe 2019 të llogaritet data 30 Qershorë 2020.
- II. Ndaj të gjithë anëtarëve të cilat nuk përmbushin këtë detyrim deri në afatin maksimal të paraparë me nenin 13 të Statutit të OFK-së për anëtarësim (31 Dhjetor 2020) do të inicohet procedura disiplinore për fshirjen e anëtarëve nga regjistri i anëtarëve të OFK-së dhe revokimin e përkohshëm të licencave të tyre.
- III. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha vendimet e Këshillit Drejtues që janë në kundërshtim me këtë vendim.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Arsyetim

Këshilli Drejtues në takimin me 12/10/2020 ka rishqyrtuar vendimet e tij mbi afatet për pagesën e taksës administrative për vitet 2018 dhe 2019. Këshilli Drejtues duke u bazuar në situatën e krijuar me pandeminë COVID 19 dhe me qëllim të krijimit të mundësive të anëtarëve për përmbushjen e obligimeve ligjore ka nxjerrë vendim me të cilin ka barazvlerësuar afatin e pagesës së taksës administrative për vitin 2018 dhe 2019 me afatin e caktuar nga Kuvendi i OFK-së për vitin 2020. Pas kalimit të këtyre afateve, do të inicohet procedura për shqiptimin e masës disiplinore të fshirjes nga regjistri i anëtarëve të OFK-së dhe revokimin e përkohshëm të licencave të tyre.

I'dërgohet :

- Anëtarëve të cilët nuk kanë përmbushë obligimet për 2018 dhe 2019
- Shërbimit Profesional të OFK-së



Kryesuesi i KD
Dr.sc. Arianit Jakupi